



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 16.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i projektrezolutës për raportin vjetor të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017.
3. Projektvendim “Për miratimin e ndryshimeve të strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ismet Beqiraj, Përparim Spahiu, Reme Lala dhe Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Agron Shehaj dhe Nadire Meçorapaj.

Të ftuar:

Evis Shurdha – Kryetare Komisioni i Prokurimit Publik

Vilma Çausholli – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës. Sot do të shqyrtojmë dy çështje.

Së pari, paraqitja dhe shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”.

Së dyti, shqyrtimi i projektrezolutës “Për raportin vjetor të veprimtarinë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017”, çështje e cila do të shqyrtohet ditën e enjte në seancë plenare.

Për çështjen e parë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”, e pranishme në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave janë kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik, zonja Evis Shurdha.

Do të procedojmë me prezantimin e strukturës së re të Komisionit të Prokurimit Publik dhe më pas me shqyrtimin.

Zonja Shurdha, e keni ju fjalën.

Jorida Tabaku – A mund ta marr fjalën, zoti kryetar?

Erion Braçe – Po, fjala për zonjën Tabaku.

Jorida Tabaku – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ne do të kishim shumë interes të përfshiheshim në diskutimin e strukturës së Komisionit të Prokurimit Publik, duke pasur parasysh edhe faktin që për këtë institucion kemi pasur objeksionet dhe shqetësimet tona, por që të gjitha kanë rënë në vesh të shurdhët, ashtu siç edhe procesi i përzgjedhjes së zonjës, i cili nuk ishte një proces i drejtë dhe ligjor. Ky komision nuk sugjeroi që zonja të rizgjidhej në detyrë, por i falënderoj kolegët socialistë, sepse na patëm një raport ku mendimet tona ishin të njëjta, por fatkeqësisht seanca plenare e votoi zonjën.

Njëkohësisht, dëshira jonë do të ishte të përfshihemi në diskutimet për raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili do të diskutohet në seancë, duke pasur parasysh se Kontrolli i Lartë i Shtetit mbetet institucioni i vetëm që raporton për situatën aktuale në rritje të korrupsionit, sidomos në nivelin qendror, por gjithashtu edhe në atë lokal, 3,2 miliardë euro llogaritet dëmi nga KLSH-ja për 5 vjetët e kaluara, dëm ekonomik. Fatkeqësisht ende sot nuk ka asnjë zyrtar pas dyerve të burgjeve, fatkeqësisht sot ky dëm ekonomik që i faturohet vetëm një personi të vetëm, Kryeministrit. Ashtu si krimi, edhe lufta ndaj drogës janë beteja të humbura të

kësaj qeverie, ashtu edhe lufta ndaj korrupsionit është beteja e radhës e humbur dhe është ndër arsyet pse Shqipërisë nuk iu hapën negociatat.

Partia Demokratike ndoqi njëkohësisht me shqetësim edhe raportin e antimafias italiane, e cila raportonte për sasi droge të dyfishuara, të kapura, në krahasim me vitin e kaluar, ku si rregull 1/10-ta e sasi së trafikuar kapet. Kjo do të thotë se edhe trafiku i drogës është dyfishuar, e cila përsëri është një betejë e humbur e kësaj qeverie. Të gjitha këto së bashku me çështjen e pronës janë kritere për hapjen e negociatave, janë kritere, të cilat qeveria nuk i ka zbatuar, ka neglizhuar së zbatuari dhe sot ndodhemi në këtë situatë.

Dhjetë ditë më parë në seancën e fundit në parlament ngritëm shqetësimin për projektin e grabitjes së tokës publike dhe private në pronën e Teatrit Kombëtar. Një formë koncesionare, partneritet publik-privat, qeveria ta quaj si të dojë, por në fund të ditës është një skemë e pastër dhe e thjeshtë e pastrimit të parave. Ligji që kaloi në parlament është një ligj antikushtetues, është një ligj që shkel të paktën 4 ligje të tjera që lidhen me qeverisjen vendore, me trashëgiminë kulturore, ligjin për koncesionet, prandaj është e kotë të sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë, të miratojmë ligje në parlament, të cilat në fund të ditës nuk do të zbatohen dhe do të shkelen me të dyja këmbët. Javën e kaluar Kryeministri miratoi ose firmosi në Samitin e Londrës një rezolutë për angazhim më të madh të qeverisë për partneritetet publike-private, e cila në fund të ditës ishte thjesht propaganda dhe shou i radhës. Pse? Sepse në qoftë se qeveria shqiptare angazhohet për të gjetur burimin e financimit të projekteve me partneritet publik-privat dhe të koncesioneve ajo e ka mundësinë ta bëjë këtë që sot, nuk ka nevojë të firmosë një marrëveshje që ta bëjë këtë, por ajo nuk do që ta zbatojë legjislacionin. Te incineratorët, një nga kompanitë e përfshira, është kompani guaskë. Rasti i Fusha sh.p.k., përsëri edhe është një kompani guaskë, që është duke u përdorur duke pastruar paratë e tjetërkujt. Një sërë koncesionesh, duke filluar nga Porti i Karpenit dhe duke vazhduar me aeroportin e Vlorës, janë të gjitha me kompani që nuk u dihet se kush është pronari dhe kjo e bën zero dhe false luftën ndaj pastrimit të parave, e bën zero dhe false luftën që ka qeveria për të siguruar më shumë transparencë.

Në rezolutën që kishte firmosur javën e kaluar Kryeministri angazhohej njëkohësisht se do të siguronte një platformë *online* për prokurimet publike, ku partneritet publike-private dhe koncesionet kishin këtë platformë. Fatkeqësisht, platforma është ofruar në vitin 2009, por që nga viti 2013 e këtij kjo platformë është totalisht e papërdorshme dhe një herë në javë platforma dhe sistemi nuk janë më *online*, duke i krijuar mundësi kujt do që ka dëshirë të fshijë dhe të heqë

dokumente sipas interesit të vet dhe kjo ka ndodhur për një sërë koncesionesh, për të cilat ne si Parti Demokratike kemi kërkuar informacion.

Kryeministri angazhohej se do të kishte garë. Si mund të ketë garë kur të gjitha koncesionet dhe partneritetet publike-private po jepen me ofertë të pakërkuar? Kur koncesioni, partneriteti publik-privat i Teatrit po jepet me një ofertë të pakërkuar, të bërë nga një biznes, i cili pretendonte se kishte tokë kufitare me teatrin, por kjo nuk është fare e vërtetë? Si mund të kemi garë kur nga projekti 1 miliard, nga 7 projekte, 4 janë bërë me ofertë të pakërkuar deri tani? Si ka mundësi që të gjitha koncesionet, që i janë dhënë shëndetësisë, të gjitha janë me ofertë të pakërkuar? Çfarë gare është kjo? E njëjta gjë ka ndodhur me çdo partneritet publik-privat, e njëjta gjë ka ndodhur me koncesionet dhe për këtë arsye kam publikuar në komision edhe tenderat për prokurimet publike, ku një në tre tendera jepet pa garë, prandaj ky është një shqetësim mjaft i madh edhe për partnerët ndërkombëtarë, edhe ndaj luftës kundër korrupsionit, por qeveria hesht dhe nuk kthen përgjigje.

Të gjitha këto, zoti kryetar, janë shqetësime që opozita i ka ngritur, janë të gjitha prioritetet në rrugën tonë për integrimin europian, janë të gjitha kritere që i duhen Shqipërisë për të hapur negociatat, por si përpara edhe pas 28 qershorit asgjë nuk po ndodh. Ne do të kishim pasur shumë dëshirë të merrnim pjesë edhe në rezolutën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, siç e përmenda pak më parë, një nga institucionet e vetme që po na ofron transparencë, duke qenë se të gjitha dritaret e tjera të transparencës janë mbyllur dhe nuk kanë më asnjë hapësirë as për opozitën, por as për tjerët që të marrin vesh se çfarë po ndodh. Pra, duke pasur parasysh situatën, duke pasur parasysh që çdo propozim yni deri më sot ka shkuar në vesh të shurdhët, duke pasur parasysh atë që ndodhi javën e kaluar në Kuvend me ligjin për Teatrin, me shkeljen e Kushtetutës, grabitjen e pronës publike dhe private është e pamundur që ne të ofrojmë bashkëpunimin tonë.

Për ligjin e teatrit, në fakt që nga viti 2002 kur i janë vënë për herë të parë sytë truallit të Teatrit Kombëtar, kanë ndodhur shumë çudira.

Së pari, nga 2002-shi e këtej zona e mbrojtur e qendrës historike të Tiranës është reduktuar dhe zvogëluar dhe kjo ka ndodhur gjithmonë sa herë qeveris Edi Rama. Ndërkohë nga 2002 e deri në 2011-ën në Bashkinë e Tiranës qeveria në mënyrë të qëllimshme ka përgjysmuar çmimin e kompensimit të tokës në vlerë financiare, duke i ulur vlerën qendrës historike të Tiranës, e ka paralajmëruar këtë gjë, duke pasur parasysh se do të vinte dita që ky ligj do të

kalonte në parlament. Qeveria në mënyrë të qëllimshme nuk jep informacion për pronësinë publike dhe private në truallin e teatrit. Nga 8600 metra, 5500 i përkasin Teatrit Kombëtar, 2100 i përkasin Bashkisë së Tiranës dhe janë shtet, në fakt edhe KLSH-ja e kishte një pronë atje, sipas informacioneve të hipotekës, ndërkohë që janë 10 pronarë privatë që kanë 1256 metra, nuk është vetëm kompania Fusha. Pse nuk i jep qeveria një ndër pronarëve të tjerë privatë mundësinë për ta zhvilluar pronën e vet, por ka zgjedhur të preferuarin e saj?

Të gjitha këto ne i kemi ngritur në komisione dhe në seancë, ashtu siç kemi ngritur shqetësimet tona për luftën ndaj krimit dhe korrupsionit dhe të gjitha shkojnë në një pikë, në moshapjen e negociatave dhe shtyrjen e vendimit, jo shtyrjen e hapjes së negociatave, për fundin e dhjetorit të vitit tjetër, e cila do të thotë se Shqipëria për sa kohë të ketë këtë qeveri, për sa kohë do të vazhdojë të marrë këto vendime, për sa kohë do vazhdojë ta shkelë me të dyja këmbët pronën publike dhe private, për sa kohë që nuk e vazhdon luftën ndaj korrupsionit, por bëhet palë me korrupsionin dhe krimin e organizuar, i ka dyert e Europës të mbyllura.

Po e përsëris edhe një herë kërkesën tonë drejtuar Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit të teatrit dhe që dekreti i Presidentit të ketë kohë për t'u diskutuar me të gjitha palët, jo ashtu siç kaloi ligji në mënyrë të papritur dhe pa u diskutuar me asnjë nga grupet e interesit në mënyrë të qenësishme. I bëjmë thirrje edhe një herë qeverisë që, në qoftë se Presidenti e kthen këtë ligj, të marrë masa për ta tërhequr ligjin, të ndërrojë mendje para se jetë vonë, sepse grabitja e pronës publike dhe private me mburojë nga parlamenti, sigurisht tregon vetëm një gjë, faktin që ata që po e bëjnë nesër e kanë vendin në burg dhe vetëm frika e tyre i detyron ta sjellin në parlament.

I bëjmë thirrje edhe një herë qeverisë që, në qoftë se kërkon të luftojë drogën, krimin e organizuar, të fillojë me heqjen e ministrit të Brendshëm. Të gjitha këto kërkesa të ligjshme, i bëjmë jo në emrin tonë, por në emër të shqiptarëve, për hapjen e negociatave dhe për vazhdimin e rrugës sonë drejt Bashkimit European.

Faleminderit!

Erion Braçe – E nderuar zonjë, shumë faleminderit për gjithçka që thatë!

Më duhet t'ju them se kjo që po bëni ju nuk ka as sens dhe as kuptim. Natyrisht, vijimi i kësaj historie thjesht dhe vetëm sa hedh fjalën në erë dhe nuk lë asgjë të qëndrojë si argument qoftë edhe si kauzë po të doni. Pra, në qoftë se ju vini në komision dhe flisni duke përfshirë edhe mënyrën se si është zgjedhur zonja që është e pranishme këtu, deri te pastrimi i parave, më vjen

keq, por ekonomi pune ky komision nuk është, por më lejoni t'ju them se as ekonomi opozitarizmi nuk është.

Për ta mbyllur fare shkurt do t'ju them disa gjëra:

Së pari, procesi përmes të cilit është zgjedhur zonja dhe procesi përmes së cilit janë zgjedhur edhe 4 anëtarët e tjerë të prokurimit publik ka qenë thellësisht ligjor. Është respektuar germë për germë ligji i ri për Komisionin e Prokurimit Publik dhe janë respektuar germë për germë të gjitha detyrimet që ky ligj i ka dhënë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe këtij komisioni. Për herë të parë në këtë Kuvend është bërë një proces, ku u është thënë edhe autoriteteve të tjera, që kanë bërë përzgjedhjen paraprake të personave, që keni gabuar dhe ne nuk pranojmë të votojmë këto emra, që nuk ka ndodhur më parë. Kjo gjë nuk ka ndodhur as për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe as për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët po bëhen nami i këtij vendi në një proces ligjor, sy e faqe edhe ndaj atyre ndërkombëtarëve, për të cilët flisni ju.

Së dyti, raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit është shqyrtuar nga ky komision në mënyrën më serioze dhe më ligjore të mundshme, proces i vlerësuar edhe nga vetë kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit këtu në Komisionin parlamentar të Ekonomisë dhe Financave. Ju zgjedhët të mos ishit të pranishëm, por të gjitha çështjet që ka ngritur Kontrolli i Lartë i Shtetit janë diskutuar një më një këtu në komision, janë bërë pyetje dhe janë marrë përgjigje për çështje të caktuar deri në detaje numrash dhe natyrisht po vijmë te një rezolutë që adreson jo vetëm vlerësimet për punën e kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë viti 2017, por edhe detyrimet që duhet të zbatojnë të gjitha institucionet e tjera përfshirë edhe vetë KLSH-në në raport me objektivat që ky institucion ka. Kush kërkon të marrë pjesë, merr pjesë, kush nuk do të marrë pjesë, zgjedh të bëjë këtë që po bëni ju. Po jua them edhe një herë tjetër që mbi punën e këtij komisioni, me prezencën apo me mungesën tuaj, nuk mund të hedhë kush baltë, sepse gjërat kanë qenë transparente, kanë qenë sy e faqe publikut dhe natyrisht ka pasur vlerësime reciproke edhe nga institucionet që e monitorojnë punën e këtij institucioni për gjithçka që është bërë këtu edhe në mungesën tuaj.

Së treti, pa asnjë lloj diskutimi çështja e pastrimit të parave është një çështje shqetësuese apo themelore për një vend, për një shtet apo edhe për ekonominë kombëtare të tij. Pa diskutimin më të vogël unë ju nxis që në rast se ju jeni e bindur, keni prova që kompania që ju përmendni, zotëria në krye të asaj kompanie, autoritete të tjera shtetërore aspo grupe të organizuara kriminale, që sipas jush fshihen pas kësaj guaske, t'i kallëzoni në institucionet ligjzbatuese të

shtetit. Ashtu siç ju e dini, çështja e pastrimit të parave apo e agjencisë respektive nuk shqyrtohet në këtë komision, arsyen pse nuk e di, kështu ka qenë në kohën kur ju e keni drejtuar qeverinë, parlamentin e të tjera me radhë dhe kështu vazhdon të jetë, por për mua nuk është mirë që është kështu, që shqyrtohet thjesht dhe vetëm si çështje kriminale dhe vetëm në Komisionin e Sigurisë Kombëtare. Do të doja pa asnjë lloj diskutimi të shqyrtohej edhe këtu, këtë gjë do t'ia paraqes edhe Kryetarit të Kuvendit, i cili ta shohë këtë lloj praktike me qëllim që të adresohen problematika që ju i keni si shqetësim në këtë komision për këtë problematikë të caktuar.

Së fundi, dua t'ju sqaroj për punën e koncesioneve. Forma e koncesionit “propozim i pakërkuar” ose “ofertë e pakërkuar”, është formë ligjore, nuk e kemi shpikur as unë që jam këtu dhe as kolegët e mi që janë këtu, as ata në qeveri e kështu me radhë, e kanë gjetur të shkruar e zeza mbi të bardhë në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat që ju keni miratuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Madje kujtoj që ka edhe një punim të gjatë shkencor, shoqëruar edhe me një libër për dobishmërinë shkencore të kësaj forme të partneritetit publik-privat, aplikuar gjerësisht edhe në Shqipëri. Mendimin tim e kam thënë publikisht këtu në këtë komision, për mua ndryshimet në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat duhet të nisin dhe të mbarojnë me eliminimin e formës së gjetur të partneritetit publik-privat në ligjin që u trashëgua prej jush, propozim i pakërkuar. Sipas atij ligji janë një mori çështjesh, një mori koncesionesh që janë dhënë në të shkuarën dhe që po jepen edhe tani. Për mua, po jua përsëris edhe një herë, ndryshimi në atë ligj duhet të fillojë e të mbarojë me eliminimin e kësaj forme të koncesionit apo të partneritetit publik-privat në ligj. Deri atë ditë, kjo lloj forme koncesioni është ligjore, në qoftë se r ju keni prova konkrete që me këtë parashikim ligjor është të abuzuar, atëherë drejtojuni agjencive ligjzbatuese të shtetit duke kallëzuar kokë më kokë cilindo individ që ka kryer vepër penale në raport me zbatimin e ligjit.

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Në qoftë se qeveria do t'i kishte marrë seriozisht raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, atëherë afera CEZ sot duhet të kishte një përgjegjës pas dyerve të burgjeve, ndërkohë që, megjithëse Kontrolli i Lartë i Shtetit deklaroi që atje ka jo një dëm ekonomik, por që atje ka një vjedhje dhe një korrupsion që i ka kushtuar buxhetit të shtetit 600 milionë euro, kemi pasur edhe një komision hetimor për këtë çështje, ky komision përveç gjetjeve të KLSH-së, të dyja raportet e këtij komisioni kanë shkruar në prokurori dhe sot nuk kemi asnjë përgjegjës. Pra, në qoftë se kjo qeveri do ta merrte seriozisht raportin dhe gjetjet e Kontrollit të Lartë të

Shtetit, atëherë të gjitha ato që janë gjetur për Tatimet, për Doganat, shumë persona duhet të ishin pas dyerve të burgjeve. A e dini që sipas raportit të fundit të performancës të Kontrollit të Lartë të Shtetit 94% e tenderave të pushtetit lokal janë me shkelje? Çfarë po bën qeveria për këtë? Çfarë masash po merren për sistemin e prokurimit? Në rregull, sistemin e gjetët, nuk po e përdorni, por e shkelni me të dyja këmbët, çfarë masash po merrni për gjetjet e KLSH-së në tendera dhe në koncesione? Është e vërtetë që forma ofertë e pakërkuar ka qenë në legjislacionin aktual të koncesioneve si përjashtim nga rregulli, por tani është bërë rregull, tani forma e ofertës së pakërkuar ekziston në çdo lloj shërbimi dhe prokurimi që jep qeveria. Po, është e vërtetë që ka qenë legjislacion, por ligje speciale, duke filluar që nga aeroporti i Vlorës, duke vazhduar me Rrugën e Arbrit, Portin e Karpenit dhe duke përfunduar me Teatrin, ku shkelet ligji i koncesioneve, sigurisht që tregojnë se nuk ka më respekt as për ligjin dhe as për Kushtetutën. Në qoftë se kemi një ligj që normon fushën e prokurimeve publike dhe të koncesioneve dhe ti sa herë që kërkon ta shkelësh sjell një ligj me një emër specifik këtu në parlament, të gjitha janë projekte të dështuara dhe do të dështojnë, ashtu siç ka dështuar edhe projekti i aeroportit të Vlorës dhe koncesioni i teatrit. Jam e sigurt se, në qoftë se sot do të ekzistonte minimumi i respektimit të ligjit, të gjitha ata që sjellin këto ligje në parlament, duhet të ishin prapa dyerve të burgjeve.

Zoti Braçe, është e vërtetë se si asnjë herë më parë, në qoftë se keni dëshirë mund të përdor edhe fjalët tuaja, ky komision sugjeroi se që nga kryetarja deri tek anëtarët e thjeshtë të Komisionit të Prokurimit Publik nuk i plotësonin kriteret. Zonja nuk kishte asnjë eksperiencë tjetër të mëparshme, ndërsa të gjithë anëtarët e tjerë ishin në shkelje të ligjit, në fakt, edhe unë edhe ju u ndiem shumë keq kur kishim të pranishëm në komision zyrtarë publikë, ata përgjigjeshin në atë nivel dhe në atë cilësi. Ky komision sugjeroi, meqenëse ligji i ri ishte hartuar në përputhje me ligjin e ri të Bashkimit Europian për pavarësi të Komisionit të Prokurimit Publik, nuk kishte kuptim që zonja, e cila ishte zgjedhur nga Kryeministri të kryente një proces farsë dhe të zgjidhej nga ky komision. Ky, kam përshtypjen, me fjalët tuaja apo me fjalët tona, si të doni, ishte konkluzioni i përgjithshëm i komisionit, por zonja prapë u zgjodh. Me forcën e kartonëve u zgjodh zonja, kaluan 4 ligjet që shkelnin Kushtetutën, kaluan 4 ligjet që shkelnin ligjin e koncesioneve dhe të partneritetit publik-privat, prandaj është e kotë që ne sot këtu të diskutojmë dhe të themi se ju keni përgatitur një rezolutë shumë të mirë për KLSH-në dhe ne nuk kemi kontribuar. Po, kemi kontribuar për çështjen e CEZ-it edhe me një komision hetimor.

Cili është rezultati sot? Sado punë të bëjnë deputetët e këtij komisioni, kur bëhesh palë me krimin, me drogën, me korrupsionin nuk ka më vullnet politik dhe rezultati i qeverisë është i qartë, pastaj. Kur nuk ka vullnet politik qeveria, çfarë duhet të bëjë opozita?

Prandaj, e përsërisim edhe një herë kërkesën tonë për tërheqjen e ligjit të teatrit, për respektimin e përjashtimit nga rregulli për ofertat e pakërkua, ku bën pjesë teatri dhe, njëkohësisht, për rezultate konkrete në luftën ndaj krimit të organizuar dhe drogës.

Erion Braçe - Zonjë, nuk dua që kjo seancë të devijojë nga rendi i ditës që ka, dhe, mbi të gjitha, të kthehet në një debat mes meje dhe jush. Sinqerisht, besoj se nuk i intereson askujt kjo, mua të parit, por, meqë, ju iu referuat aferës në CEZ, është ngritur një komision hetimor parlamentar për ju, ashtu siç Kuvendi ka ngritur edhe një komision tjetër hetimor parlamentar. Të dyja komisionet, pas konkluzioneve të tyre, mbështetur edhe në çfarë ka thënë Kontrolli i Lartë i Shtetit, i janë drejtuar prokurorisë. Në kohën kur i janë drejtuar prokurorisë, nuk ka qenë Prokurore e Përgjithshme zonja, të cilën ju e anatemoni nga mëngjesi deri në mbrëmje, por ka qenë Prokuror i Përgjithshëm me mandat të plotë një zotëri, të cilin ju e keni lavdëruar pa fund.

Tani në momentin që Prokuroria e Republikës vendos që, pavarësisht kallëzimit tuaj, nuk ka vepër penale, vendimi i prokurorit rrëzohet ose nga prokurori më i lartë, që është Prokurori i Përgjithshëm, ose nga gjykata. Në dallim nga ju, zotëria që ka drejtuar komisionin e dytë parlamentar për aferën në CEZ i është drejtuar gjykatës, e cila ka marrë vendim të detyrojë prokurorinë ta hetojë këtë çështje dhe ajo po hetohet. Nëse ju nuk bëni punën tuaj, siç e ka bërë ai zotëria, nuk është çështja ime dhe as e këtij komisioni parlamentar. Pra, të bënit atë që bëri ai zotëria tjetër dhe ta kishit ndjekur këtë çështje në rrugë ligjore në një gjykatë që nuk e ka emëruar Partia Socialiste dhe me gjyqtarë që nuk i ka emëruar as Partia Socialiste, as KLD-ja e Partisë Socialiste dhe as ata anëtarë KLD-je që i keni votuar ju në të gjithë hierarkinë e tij nga Kuvendi i Shqipërisë deri në institucionet e tjera siç është Konferenca Gjyqësore, që i ka zgjedhur ata njerëz.

Së dyti, zonjë, në ligj forma “propozim i pakërkuar” për koncesionet ose për partneritetin publik privat nuk ka asnjë cilësim, siç thoni ju, përjashtim nga rregulli. Është një ndër format që janë listuar në ligj në mënyrë të qartë dhe që mund të aplikohen nga kushdo. Më lejoni t’ju them që me këtë formë janë nënshkruar minimumi 319 kontrata koncesioni ose partneriteti publik privat, që po shkatërrojnë Shqipërinë, si hidrocentrale të vegjël, të mesëm. Kjo është historia. Nuk ka qenë përjashtim nga rregulli kur janë mbi 319 kontrata, sipas kësaj forme, sipas së cilës

qytetarët shqiptarë paguajnë nga xhepi i tyre tarifat nga porti i Durrësit deri te kolaudimi i automjeteve, sepse nuk ka qenë përjashtim nga rregulli, por ka qenë rregull në të paktën 5 koncesione të tjera shërbimesh, ku nuk paguan qeveria, por paguan qytetari nga xhepi i tij.

Kjo është një histori që duhet të marrë fund. Sipas mendimit tim, koncesione ose kontrata koncesionare me formën “propozim i pakërkuar” nuk duhet të ketë. Kur të vijë ligji, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka marrë përsipër të hartojë ligjin e ri, po e diskuton draftin me palët respektive, unë besoj se në shtator do të jetë në Kuvend, atëherë gjithsecili nga ne ka gjithë të drejtën të bëjë propozimet e tij. Unë e kam zënë radhën, kam një vit a mos më tepër që e kërkoj këtë gjë: eliminimin e formës “propozim i pakërkuar” nga ligji për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

Së fundi, nuk arrij të kuptoj pse insistoni te procedura e ndjekur nga Kuvendi ose ky komision për rastin e përzgjedhjes së kandidatëve ose anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Po ta lexoni relacionin, ka një vlerësim individual për të gjithë kandidatët për rastin e parë, siç edhe në rastin e dytë, dhe vlerësimi për zonjën që është këtu, është i ndryshëm nga ai që thoni ju.

Ju lutem, referojuni dokumenteve parlamentare, të nxjerra nga ky komision, në momentin kur kërkon të jepni konkluzione në emër të këtij komisioni. Procedura ligjore e ndjekur në këtë komision, dy herë për rastin e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, ka qenë e mbështetur germë për germë në ligj dhe në Rregulloren e Kuvendit, pra në ligjin e ri, që i dha atributet Kuvendit në raport me Komisionin e Prokurimit Publik dhe natyrisht edhe në Rregulloren e Kuvendit, që ka përcaktime të qarta pikërisht për të bërë gjënë e duhur në raport me Komisionin e Prokurimit Publik. Ne besojmë se kemi bërë gjënë e duhur në raport me Komisionin e Prokurimit Publik këtë herë.

Edmond Spaho - Zoti kryetar, kur na drejtoheni ne si opozitë, se flasim jashtë rendit të ditës, në fakt, e keni ju gabim, pasi çështjet që po ngremë janë të lidhura direkt me Komisionin e Prokurimeve Publike, për shembull, kontrata e teatrit është një nga çështjet për të cilat Komisioni i Prokurimeve Publike duhet të ngrejë zërin. Pse nuk respektohet?

Erion Braçe- Ju lutem, unë ju mirëkuptoj, mund të thoni gjithçka, por jo gjëra që nuk kanë lidhje me rendin e ditës.

Edmond Spaho – Ju lutem, më dëgjoni!

Erion Braçe - Zoti Spaho, besoj se ju e dini mirë që Komisioni i Prokurimeve Publike vihet në lëvizje thjesht vetëm me një ankesë, pra vetëm nëse ka një ankesë për një çështje. Ju nga njëra anë thoni që nuk është bërë garë dhe, nga ana tjetër, thoni pse nuk është implikuar Komisioni i Prokurimeve. Po si të implikohet kur nuk ka pasur garë?

Edmond Spaho- Ju lutem, më dëgjoni një herë, pastaj nevrifikosuni!

Kontrata e Teatrit është në juridiksionin e këtij institucioni. Nuk është respektuar ligji i prokurimeve publike, për këtë është ky institucion, të ngrejë zërin kur nuk respektohet ligji i prokurimeve publike.

Së dyti, nuk është respektuar ligji i koncesioneve. E keni dëgjuar këtë institucion të shprehë këtë shqetësim? Bëhet fjalë për pronë shtetërore. Pra, ky komision a është për të administruar në mënyrë të përshtatshme, të rregullt, efektive pronën publike në raport me privatët? Atëherë, përse nuk e ngre zërin ky komision se tokën, që është pronë publike, nuk është e drejta e Kuvendit, t'ia transferojë privatit?

Me Kushtetutë këtë të drejtë e ka pushteti vendor. Ajo që keni bërë me ligj është shkelje, nuk mund t'ia marrësh pushtetit vendor të drejtën, pa ndryshuar Kushtetutën. Për këtë duhet ta ngrejë zërin Komisioni i Prokurimeve Publike, sepse prona shtetërore po i prokurohet privatit jashtë rregullave që kemi ne. Duhet ta ngrejë zërin edhe për çmimin që nuk respektohet çmimi i tregut, i cili në atë zonë është rreth 2 mijë euro. Kur Kryeministri i shkel këto rregulla dhe institucionet bëhen palë me Kryeministrin, janë edhe ato fajtorë.

Ju thoni që ndarja e parave nuk paska të bëjë. Si nuk paska të bëjë? Nëse në një aktivitet, ku shteti ka pjesën e tij, nuk janë të qarta burimet e financimit, ne duhet të rrimë indiferentë? Nga dalin paratë? Si financohet kur sistemi bankar nuk jep kredi? Jo vetëm në këtë rast, por në shumicën e rasteve ku po ndërtohet, a mund të më thoni ju nga vijnë paratë? A nuk ju shqetëson ju, si kryetar i komisionit, fakti që të gjitha institucionet ndërkombëtare ngrenë çështjen se në Shqipëri po lahen paratë, forma kryesore është nëpërmjet ndërtimit dhe forma e dytë është nëpërmjet partneritetit publik privat? Kur shteti me pronën shtetërore hyn në një marrëdhënie me privatit, ne nuk duhet të dimë nga vijnë paratë? Në një shtet normal demokratik me rregulla, paratë vijnë nga bankat, ose do të marrësh kredi, ose i ke të depozituara në bankë, nuk ka vetëfinancim, që do të thotë, duhet t'i kesh të administruara në bankë, ndryshe janë nga burime jo të ligjshme. Prandaj Departamenti i Shtetit ka thënë që Shqipëria është problem i madh për pastrimin e parave. Këto janë disa çështje, që po të mbetesh ngushtësisht te rendi i ditës që po

shqyrtojmë sot, i takojnë edhe Komisionit të Prokurimeve Publike, pa folur pastaj për Kontrollin e Shtetit, që e ka detyrën numër një.

Sot në rendin e ditës shqyrtojmë edhe rezolutën për punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, për një mori çështjesh që ata kanë ngritur dhe që rezulton që të jenë shpërdorime të pronës shtetërore ose të financave të vendit. A nuk është çështje e Komisionit të Prokurimit Publik të ngrejë zërin për shpërdorimet që po u bëhen financave shtetërore, duke i dhënë koncesionarit të Fierit për ngritjen e inceneratorit para pa bërë punë? Mori një dorë parash, nuk ka filluar punë sipas kontratës, por tani po merr transhin tjetër. A nuk ju shqetëson ju kjo që në një raport ndërmjet shtetit që involvon shtetin, privatin dhe financat, privati merr paratë dhe nuk bën punë?

Sa për atë që kredencialet e kësaj zonje qenkan të shkëlqyera, ju duhet të ishit i pari që të ngrinit zërin, madje, po të isha unë, nuk do të punoja më me këtë institucion, nga mënyra si nëpërkëmbi vendimin që morët vetë ju këtu. Ngaqë nuk e kishe rakorduar me shumicën tënde, u përpoqe të mbash qëndrim profesional, por te ju nuk pyesin shumë për qëndrime profesionale. Atë vendim që more këtu, që të mos përdor ndonjë fjalë jo etike, sepse kemi miratuar edhe Kodin e Etikës, ta hodhën poshtë.

Dashamir Shehi – Sa i përket Komisionit të Prokurimit Publik, ne e kemi bërë të qartë mendimin tonë që në atë kohë.

Njëherë ky qe një ligj i panevojshëm, ky ishte një institucion brenda kryeministrit, ishte bërë me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të rrinte fare mirë atje. Kjo lloj teorie, sipas së cilës sillen ligje këtu për të mbuluar të gjitha pislleqet e Këshillit të Ministrave, është shumë e gabuar për parlamentin. Ne nuk jemi noterët e Kryeministrit. Ai zotëria duhet të marrë përgjegjësinë e vet, sepse ky ligj nuk ndryshon absolutisht asgjë. Këta njerëz duhet të jenë shërbëtorët e Kryeministrit, siç ishin edhe pa atë ligj, ligji nuk është se i bën të pavarur, të kenë ndonjë hapësirë tjetër për të kontrolluar diçka. Kështu që unë gjykoj që ky institucion mund të qëndronte më dinjitoz siç ishte përpara, do të ishte edhe më i kontrollueshëm, në fund mund ishte një levë pranë Këshillit të Ministrave. Po të ishte për mua, do ta kisha hequr fare, sepse u bënë vite që nuk luan asnjë lloj roli. A e dini ku luan rol? Luan rol vetëm kur brenda një tenderi janë dy ortakë, që luftojnë kush ta kapë tenderin, pra atëherë vihet ky mekanizëm në punë. Kjo ka ndodhur me këtë qeveri dhe me qeverinë tjetër. Ky ka qenë funksioni i këtij komisioni. Po të ketë bërë ndonjë punë të mirë për shtetin shqiptar të kenë kthyer ato gjëra që ishin hajdutllëqe, do

të ishte shumë mirë, atëherë jo vetëm me këtë organikë, por do ta kishim bërë dy herë më të madhe. Deri sot këtë punë kanë bërë. Do ta mbyll komentin këtu.

Tani të vijmë te çështja tjetër. Më bëhet qejfi, zoti kryetar, që bie dakord që do ta mbyllim këtë lloj forme të koncesioneve. Nuk më bëhet qejfi që kjo ka punë 5 vjet këtu që diskutohet dhe është shtyrë deri në ditën kur të mbarojnë edhe ato pak para që ka Shqipëria, pra pasi t'i kenë ndarë të gjitha. Kështu që heqja e kësaj forme koncesioni është vetëm një përrallë për propagandë. Unë e di fort mirë që edhe koncesionet e qeverisë së vjetër nuk ishin fort transparente. Madje, nëse doni ta dini, koncesionin e Rapiskanit të famshëm do ta kisha mbyllur, sepse edhe ajo është një formulë abuzimi mbi biznesin shqiptar. Ju nuk e bëtë, por mbi atë abuzim shtritë 100-fish abuzimet në të gjithë sektorët.

Ajo që thoni për hidrocentralet nuk është e vërtetë. Ka një formë klasike të dhënies së hidrocentraleve, është krejt ndryshe nga kjo që ka bërë kjo qeveri. Është e drejta e koncesionit që shteti t'ia japë ujin, ndërsa ai të japë paratë. Hidrocentralet nuk fusin në borxh shtetin shqiptar. Një formë tjetër ishte t'i japësh minierën të nxjerrë mineralin, ai të fusë paratë. Këto ishin forma koncesioni që i dhanë një zhvillim vendit. Sigurisht që kanë 100 mijë të meta, për ambientin ose për mënyrën si janë dhënë, por ama janë dhënë me garë. E dini fort mirë që për një përrua futeshin në garë tri- katër firma. Ka qenë e pastër gara, mbase edhe jo, por nuk është kjo formë koncesionare, kështu që ideja që ju keni dhënë 300 e 400 dhe ne po japim 20 është e gabuar. Ajo qeveri që ka qenë përpara ka dhënë nja 3-4 shërbime, mund të jenë të gabuara, unë do t'i kisha mbyllur të gjitha. Pra, do t'i kisha vënë shkëlmin këtij lloj hajdutërie pa asnjë lloj precedenti që ka 5 vjet dhe e ka futur në borxh Shqipërinë edhe për 10 vjetët e ardhshëm.

Në cilin vend ka bërë vaki që të mos jetë dhënë një koncesion normal por vetëm me ofertë të ofruar nga një individ i vetëm? Janë dhënë 3-4 rrugë, asnjë nuk është bërë deri sot. Shifrat janë të tmerrshme. Jemi ankuar kot për Rrugën e Kombit. Shikojeni sa e ka shifrën kjo rruga e re që është 30 kilometra midis fushës! Shikojeni sa e kanë shifrën ato 60 kilometra me dy karregjata që do të bëhet rruga e Arbrit, megjithëse janë harxhuar disa para deri sot. Shikojeni sa i kanë shifrat të gjitha segmentet e tjera të bëra me ofertë. Janë të gjitha abuzime të pastra. Të mos flasim pastaj për stadiumin, për teatrin, për të cilin po bëhet kjo zhurmë. T'i lëmë pastaj koncesionet në shëndetësi për ilaçet, spitalet, dializat, asnjë nuk ka një formë të rregullt ligjore, që të jetë bërë me garë. Janë bërë gjatë darkimeve të ministrave.

Po të jetë për mua, edhe ato të vjetrat do t'i hiqja, sepse në sebeb të atyre është vazhduar të vidhet 5-6 vjet në mënyrë galopante, sepse, po të shikosh, shifrat janë 10-fishuar.

Tani të vijmë te teatri, jo se është gjëja më e rëndësishme por kjo është e turpshme, sepse bëhet në dritë të diellit në mes të ditës, në mes të Tiranës dhe të gjithë bëjnë sikur nuk e kuptojnë. E vetmja që ka vlerë aty, është teatri vjetër. Po të jetë për të bërë vatra kulture, bëhen sa të duash, por aty problemi është për të ndërtuar 6-7 kulla, për të marrë tokën e shtetit, të qytetarëve të Tiranës për t'ua dhënë 2-3 biznesmenëve. Kjo është e gjitha. Unë nuk besoj se ka budalla, brenda ose jashtë kësaj salle, që nuk e di se Edi Rama i gjurmon asaj copë toke për të bërë gradaçela. Dhe sot bëjnë sikur kjo qenka shpikja më e madhe, se dashka ta bëjë Shqipërinë me teatër, siç e bëri Shqipërinë me stadium. A e shikoni çfarë shëmtire është? Është një supermerkatë që ka një fushë futbollit. Kishte kapacitet 18 mijë vendesh tani ka 22 mijë. Asnjë gjë nuk është bërë, veçse është bërë një kullë 3- katëshe. Asgjë më tepër, e shëmtuar që i ka dalë si hu hotelit, muzeut përpara. Kjo ishte shpikja? Këtë do të bëjë edhe me teatrin. Do të dalë një bllok në mes të Tiranës dhe të gjitha këto na shiten për shpikje të mëdha financiare, zhvillim, modernizim. Ky është modernizimi i Afrikës. Afrika zhvillohet kështu. Edhe te ne një dorë qeveritarësh së bashku me një dorë biznesmenësh, vjedhin atë që i ka tepruar Shqipërisë, bëjnë shëmtirat që kanë bërë deri sot, dhe këtë e quajnë zhvillim. Kjo është vjedhje e pastër. Të paktën neve na takon të reagojmë. Ju po i votoni, po i mbuloni, po i jepni koperturë, kësaj lloji shtate. Do të vijë dita që do të dalin këto muhabete, nuk është se po i nxjerrim ne, po i nxjerrin, ata që na vëzhgojnë, të huajt. Do të vrasim mendjen një ditë se nga vijnë gjithë këto miliona në një vend fukarenjsh. Çfarë është ky vend që për të bërë një ujësjellës dy milionë lyp lekë nga Banka Botërore; për të bërë një copë rrugë, lyp para nga fondet ndërkombëtare, kur vjen puna për pallate 200 milionë i paskan paratë vetë? Po kush e ha këtë lloj përralle? Ky vend nuk ka para për të vënë një rubinet, kur vjen puna për ndërtesa 30 dhe 40 katesh i gjen paratë. Edhe ju mendoni se ata janë budallenj dhe nuk po na hetojnë ne? Prandaj do t'ju ftoja të reflektojmë, sepse këto janë tema të mëdha dhe do të ngelen shumë vite përpara. Edhe gjysma e atyre gradaçelave do të ngelen si varrezë mes Tiranës, siç ka ngelur njëri përballë Kishës, që ka 10 vjet në atë gjendje. Kjo është situata.

Ju ftoj, meqë e paskeni dëshirën edhe ju, kryetar, për ta hequr ligjin, ejani ta heqim një ditë e më parë, se, siç thonin ju, që do ta heqim në vitin 2019, atëherë s'do të ketë më para e nuk do të ketë mbetur gjë. E gjitha kjo, më pas do të jetë bisedë boshe.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Kushi e ka fjalën.

Evis Kushi – Duke respektuar të gjitha shqetësimet që ngre opozita, fjalën e kërkoja për procedurë, kështu që për atë do të flas.

U bënë kaq muaj që ne, kolegët e maxhorancës, ngremë shqetësimin se këtu nuk zhvillohet debat. Mënyra se si kolegët e opozitës e kërkojnë fjalën për procedurë dhe pastaj flasin për çështje të ndryshme duke u hedhur nga njëra degë në tjetrën, është e pamundur që të zhvillohet debat për çështjet që ju ngrini si shqetësim.

Ajo që më bën përshtypje është se, kur problemet vijnë si çështje të rendit të ditës, ju nuk vini në seancë dhe nuk debatoni, ndërkohë, kur vijnë çështje të tjera, ju ngrini çështjet për të cilat keni munguar. E kam fjalën për raportin e KLSH-së. E diskutuam, sot ngrini shqetësime në lidhje me sugjerime, apo vendime të KLSH-së, ndërkohë që e kishit mundësinë të vinit ta diskutonim kur kjo çështje ishte në rendin e ditës.

E njëjta gjë është bërë edhe për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Zhvilluam seancën dhe ju nuk erdhët. Sot vini dhe ngrini shqetësimin që mund ta kishit ngritur ditën e caktuar. Si mund ta zhvillojmë këtë mbledhje kur ju flisni për çështje dhe hidheni nga një degë në tjetrën? Çfarë duhet të bëjmë ne, t'i marrim një për një këto akuza dhe ndërkohë rendi i ditës të mos diskutohet fare? Pastaj, jam dakord me kolegun Shehu, del se është bisedë boshe. Është e tillë në momentin që çohesh, merr fjalën për procedurë dhe flet për të gjitha, që nga Teatri, koncesionet, rendi, krimi etj. Normal që ky lloj diskutimi nuk ka eficiencë.

Ejani t'i marrim çështjet me radhë, kemi sot rendin e ditës, t'i diskutojmë, kemi mundësi t'i debatojmë, të ngrini edhe probleme. E kam thënë edhe herë tjetër, që parlamenti i ka të gjithë mekanizmat, që për çdo lloj shqetësimi të kërkojmë seanca dëgjimore, interpelanca, po kështu, edhe në seancë plenare është mundësia e diskutimit në kohën prej 60 minutash, pas rendit të ditës.

Ju lutem, t'i rikthehemi rendit të ditës e të diskutojmë me radhë çështjet e sotme.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Kushi flet këtu sikur jemi në një sistem normal. Para 1 jave këtu është shkelur Kushtetuta me dy këmbë, ka rënë komplet sistemi, ndërsa kjo thotë: “Ejani të zbatojmë Rregulloren e Kuvendit!”. E kupton që shteti ka rënë? E kupton që shteti është bërë

palë me krimin dhe me drogën dhe ne duhet të ulemi këtu e të flasim sikur nuk ka ndodhur asgjë?

Javën e kaluar parlamenti ra; javën e kaluar u shkel Kushtetuta; javën e kaluar ndodhi ajo që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë, sollët një ligj, një aferë galopante korrupsioni duke shkelur edhe Kushtetutën, edhe ligjin e pushtetit vendor, një ligj të miratuar me 3/5-at, pavarësisht se ishte kundër i gjithë komuniteti i artistëve, qytetarët, opozita, pavarësisht se ka 5 muaj që diskutohet. Çfarë duhet të bëjë opozita, të sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë?

Përsërisim edhe një herë kërkesat tona: për ne, në këtë komision do të ketë diskutime normale atëherë kur të zbatohen ligji dhe Kushtetuta. Për sa kohë që qeveria zgjedh të heshtë dhe të mos dëgjojë asnjë nga propozimet e opozitës, për sa kohë që qeveria i bën ligjet me korrupsion, për sa kohë që qeveria tashmë nuk ka më frikë, nuk fshihet dhe na sjell edhe emrat e biznesmenëve deri në parlament, sigurisht që opozita nuk mund të sillet normalisht në një vend që nuk është normal, në një vend, i cili 5 vjetët e fundit ka pasur vetëm degradim.

Kemi qenë konstruktivë në këtë komision dhe në seancë, kemi dhënë propozimet tona, por çdo gjë e ka një limit. Me ligjin e Teatrit, me shkeljen e Kushtetutës me ligj, me shkeljen e 5 ligjeve të tjera të bashkëpunimit me opozitën ju i thatë - “Jo!” .

Përsëris edhe një herë kërkesën tonë për Presidentin e Republikës, përsëris edhe një herë kërkesën tonë për tërheqjen nga ligji korruptiv i aferës së Teatrit Kombëtar, kërkojmë edhe një herë kthimin e parlamentit në binarët kushtetues duke respektuar Kushtetutën dhe vullnetin e shumicës, i kërkojmë edhe një herë qeverisë të tërhiqet nga afera korruptive e Teatrit!

Faleminderit!

Erion Braçe –Zonja Tabaku, ju mund të keni axhendën tuaj, dhe keni të drejtën të bëni çfarë të doni...

(Zoti Spaho lë sallën e mbledhjes)

Për këtë po flisja!

...por nuk ia impononi dot anormalitetin tuaj këtij komisioni.

Në rast se doni të flisni për çështje që kanë lidhje me rendin e ditës, dakord, në rast të kundërt, siç e zgjodhët rrugën për të ikur, ikni!

Së dyti, nuk do ta thosha, sepse zoti Spaho lëvizi, por, meqë po e kërkon me ngulm, ky është procesverballi i seancës kur është votuar zonja në fjalë. Në atë seancë, zonja në fjalë ka marrë 75 vota, por që nuk janë të maxhorancës, sepse në atë seancë kanë munguar të paktën 8

deputetë socialistë, plus që edhe Erion Braçe, zonja e di, ka votuar kundër, bëjnë 9, që do të thotë se këta që ishin këtu dhe u larguan kanë votuar për zonzën, siç ka votuar edhe një pjesë e maxhorancës, që ka qenë në sallë atë ditë. Kështu që historitë kur votimi është i fshehtë, votohet dhe pastaj vihet këtu sulmohet komisioni, sulmohet zonja etj. me radhë, për më tepër flitet në emër të dokumenteve parlamentare, kur ato në mënyrë shumë të qartë bëjnë vlerësime të caktuara për zonzën, ashtu siç kanë bërë vlerësime të qarta dhe transparente për të gjithë ata të tjerët, që erdhën jo një herë, por dy herë dhe kandiduan për Komisionin e Prokurimit Publik, kjo pastaj është tej normales, amorale, e thënë shqip dhe qartë.

Pastaj pjesa tjetër: unë kam në mendje këtë gjë për Teatrin; kam në mendje këtë gjë për stadiumin; kam në mendje këtë gjë për rrugën, ujësjellësin e ku di unë, pse nuk flet kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik, kjo pastaj është histori komplet tjetër. Komisioni i Prokurimit Publik e ka të përcaktuar me ligj detyrën dhe mënyrën se si investohet në një çështje të caktuar. Në rast se nuk ka garë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk hyn kurrkund. Zoti Spaho, zonja Tabaku dhe cilido tjetër mund ta kenë shumë të madhe dëshirën që kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik të flasë, por ajo nuk është ligjëruese dhe as poete që të komentojë këngë, për më tepër tallava, që përsëriten në Komisionin e Ekonomisë nga mëngjesi deri në mbrëmje. Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik e ka të përcaktuar me ligj detyrën që të raportojë çdo vit para Komisionit Parlamentar të Ekonomisë. Këtë thotë ligji dhe ky ligj do të zbatohet deri në fund.

Sot është para këtij komisioni për të prezantuar strukturën e re të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas detyrimeve që ka përcaktuar ligji në fuqi. Për këtë arsye është këtu. Në qoftë se deri dje strukturën e miratonte vetë, pa asnjë lloj diskutimi që me ligjin e ri e harton vetë, e paraqet para këtij komisioni dhe ky komision gjykon mbi të dhe më pas miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Fjalën e keni ju, zonjë, për të prezantuar strukturën e re të Komisionit të Prokurimit Publik.

Evis Shurdha – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç ju është vënë në dispozicion, kemi përgatitur një relacion për ndryshimet strukturore të paraqitura pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar” dhe ligjit nr. 47/2017, që parashikon ndryshimet e fundit ligjore, në zbatim të pikës 2 të nenit 19/1 të

këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik i pavarur, që financohet nga buxheti i shtetit.

Struktura e re organizative i propozohet Kuvendit për miratim në zbatim të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”, në mbështetje të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Departamentit të Administratës Publike.

Struktura dhe organika ekzistuese e Komisionit të Prokurimit Publik është miratuar me urdhër të Kryeministrit në kohën kur ky komision ishte agjenci varësie e Kryeministrisë. Në urdhrin nr. 60, datë 12.05.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik” numri i punonjësve është 30, mes të cilëve përfshihen edhe kryetari, zëvendëskryetari dhe tri anëtarët. Kjo strukturë organizative përbëhet nga 2 sektorë: 2 përgjegjës sektori, 14 inspektorë, 5 specialistë, 1 specialist IT-je, sekretarë dhe 2 punonjës mbështetës. Pra, në total 30 punonjës gjithsej.

Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve, PPP-ve, lejeve minerare dhe ankandeve, është krijuar me anë të ligjit nr. 9643, datë 20.11. 2016 “Për prokurimin publik”.

Referuar të dhënave të administruara, rezulton se nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2017, ashtu siç kemi raportuar pranë këtij komisioni, janë dorëzuar 1099 ankesa. Rritja dhe numri i lartë i ankesave, si dhe kompleksiteti i tyre si pasojë kanë sjellë zgjatjen e periudhës së shqyrtimit të ankesave dhe vendimmarrjen e këtij organi kolegjal. Nga ana tjetër, situata e krijuar për shkak të rritjes së numrit të ankesave ka sjellë si pasojë edhe rritjen e volumit të punës për inspektorët përkatës.

Nevoja për riorganizim vjen edhe si rezultat i analizave dhe konkluzioneve të arritura gjatë periudhës 2017-2018 për rritjen e aftësisë së përdorimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore me qëllim kryerjen e detyrave dhe funksioneve rregullatore, të fokusuara në mënyrë të veçantë në rritjen e gamës dhe cilësinë e mbrojtjes së interesit publik në sektorin e prokurimeve publike.

Për shkak të funksionit të tij të veçantë, problemeve dhe vështirësive të hasura gjatë veprimtarisë funksionale të tij, duke marrë në konsideratë faktin se struktura aktuale e Komisionit të Prokurimit Publik nuk është në përputhje me nevojën bazë të institucionit, gjykojmë se ndodhemi para nevojës së një ristrukturimi të shpejtë të strukturës së tij.

Vlerësuar në këtë kontekst, nevoja kryesore e ndryshimit të strukturës organizative vjen për shkak të mbështetjes në pikën 1 të nenit 19/6 të ligjit nr. 9643 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”, që është detyruese për Komisionin e Prokurimit Publik, referuar VKM-së nr. 893, datë 17. 12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse të organizimit të brendshëm të institucionit të administratës shtetërore, si edhe për procedura të hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe organizimin e brendshëm”, si edhe ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, ku në përbërjen organizative të tij, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të ketë pozicionin e sekretarit të Përgjithshëm si nëpunësi më i lartë civil në institucion.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, propozojmë strukturën organizative si më poshtë: kryetar, nënkryetar, tri anëtarë, një sekretar, një këshilltar, një sekretar i Përgjithshëm, një drejtor, 16 inspektorë, 1 përgjegjës Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, 2 specialistë IT-je, 1 specialist financë-buxhet, 1 specialist arkiv-protokoll, 2 specialistë juristë, 1 specialist për marrëdhëniet me jashtë, 1 specialist arkivi, 1 sanitar dhe 1 shofer.

Funksionet e drejtorisë së shqyrtimit të ankesave janë funksione ndihmëse dhe këshillimore në procesin e shqyrtimit administrativ të ankesave të paraqitura pranë komisionit për procedurat e prokurimit publik, verifikimi i ankesës nga ana formale, si dhe përgatitja e projektvendimit mbi themelin e ankesës.

Rritja e numrit të inspektorëve pranë Komisionit të Prokurimit Publik do të sjellë nevojën e krijimit të një drejtorie duke zëvendësuar sektorin e shqyrtimit të ankesave. Konkretisht propozojmë që të krijohet Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave, e cila do të jetë e organizuar me 1 drejtor dhe 16 inspektorë në varësi direkte të drejtorit të Drejtorisë së Shqyrtimit të ankesave. Në total, kjo drejtori do të ketë 17 punonjës.

Në drejtim të nevojës së mbulimit të funksioneve rregullatore dhe administrative të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, struktura ekzistuese ka mungesa të burimeve njerëzore. Për këtë arsye, propozojmë shtimin e një specialisti IT-je, duke pasur parasysh edhe implementimin e një sistemi të ri *smart data*.

Gjithashtu, jemi vendosur në vështirësi edhe në marrëdhëniet me jashtë, ku institucioni ynë nuk ka një punonjës, i cili të ndjekë ekskluzivisht organizimin e raportimeve në

bashkëpunim si me autoritetet e tjera analoge, organizmat ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit, si edhe me partnerë të tjerë në funksion të fuqizimit të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit dhe praktikave më të mira në lidhje me zhvillimet në fushën e prokurimeve publike. Pra, në fushat e lartpërmendura është e nevojshme prania e dy specialistëve.

Sa i përket pozicionit të sekretarit të Përgjithshëm dhe këshilltar, këto pozicione përcaktohen në ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar" dhe gjejnë zbatim në vendimin nr.187 datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë".

Efektet financiare për vitin 2018 janë paraqitur në relacionin tuaj, por vlen të theksohet se efektet financiare të shumave shtesë të llogaritura si më sipër për pagat dhe sigurimet, do të fillojnë në vitin 2018, pasi nga momenti i implementimit të saj e deri në përfundim të vitit 2018, nuk shfaqet nevoja për shtesë fondi.

Duke iu referuar strukturës aktuale dhe numrit të stafit efektiv, të cilët janë në marrëdhënie pune pranë KPP - së, numri i stafit gjatë vitit 2018 ka qenë më i ulët sesa buxheti i miratuar për të, që do të thotë se e përballojmë me fondet tona.

Struktura e re organizative dhe organike e KPP-së, e krahasuar me atë ekzistuese, ka një shtesë prej 6 punonjësish: 1 sekretar i Përgjithshëm, 1 këshilltar, 2 inspektorë dhe 2 specialistë. Kurse, pozicioni "drejtor" ka zëvendësuar atë të "përgjegjësit të sektorit".

Ristrukturimi i strukturës organizative të KPP-së përmban:

- Shtesë në kabinetin ndihmës, duke shtuar 1 këshilltar.

- Shtesë në nivelin e lartë drejtues, duke përfshirë edhe pozicionin e sekretarit të Përgjithshëm.

- Ndryshim të emërimit të njësisë organizative në nivel drejtorie.

- Shtesë në numrin e punonjësve në shërbimin civil, duke përfshirë 2 inspektorë dhe 2 specialistë.

Të dhënat e nëpunësve ekzistues në pjesën më të madhe të tyre dhe kërkesat specifike në nivel përgjegjës sektori dhe specialist në përshkrimet e punës janë të kënaqshme, kështu që sistemimi i tyre sipas pozicioneve të reja të punës nuk do të jete problem.

Nëse do të ketë raste kur të dhënat e tyre nuk do të përputhen plotësisht me përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike sipas strukturës së propozuar, atëherë këto raste do të trajtohen në

përputhje me parashikimet ligjore të ligjit për shërbimin civil, si dhe mundësinë e sistemimit të tyre me pozicione alternative.

Ju faleminderit!

Erion Braçe - Ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Në relacion ju thoni se nevoja për këtë strukturë të re dhe për këtë shtesë në strukturë vjen si rezultat i situatës së re të krijuar për shkak të rritjes së numrit të ankesave.

Në fakt, ju raportuat për vitin 2017 dhe ne i kemi të gjitha statistikatat në lidhje me numrin e ankesave gjatë vitit të kaluar në krahasim me vitet e tjera. Do të doja një informacion të shkurtër për 6-mujorin e parë të vitit 2018. Si ka qenë ecuria e këtyre ankesave? Ndoshta jo me shifra ekzakte, por përgjithësisht.

Faleminderit!

Evis Shurdha – Ju faleminderit!

Aktualisht, deri ditën e sotme, Komisioni i Prokurimit Publik ka administruar 448 vendime themeli, që do të thotë, në lidhje me statistikën e numrit të ankesave të paraqitura, nuk mund t'ju them një numër të saktë, por numri i vendimeve është i saktë, se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faktorët, indikatorit i paraqitjes së numrit të ankesave jo gjithmonë është i lexueshëm si përmirësim apo përkeqësim i situatës, sepse vullneti i operatorëve në paraqitjen e ankesës mund të jetë i ndryshëm. Pra, indikatorit nuk mund të lexohet si përmirësim apo përkeqësim. Gjithsesi, është i njëjti trend. Si gjithmonë vazhdon të jetë historia e shërbimit të sigurisë fizike, që është gjysma e ankesave që në fillim të vitit. Ne po mundohemi të kapim afatet, të cilat jemi angazhuar edhe përpara komisionit tuaj, e shqyrtimit 30-ditor të ankesave, por duhet të keni parasysh që kjo strukturë, aktualisht KPP-ja, ka 1 vit e gjysmë që nuk rekruton dot punonjës për shkak të mungesës së strukturës dhe mbylljes së planit vjetor të rekrutimeve nga ana e DAP-it në momentin kur KPP-ja ishte në varësi të Këshillit të Ministrave. Kështu që kjo situatë tranzitore ka ndikuar.

Erion Braçe - Ka pyetje të tjera? Po, urdhëroni!

Edmond Haxhinasto - Faleminderit!

Zonja kryetare, kur bëtë prezantimin gjatë kandidimit tuaj, ju bëra një pyetje nëse keni kapacitete të mjaftueshme në institucion dhe ju thatë: -“Po, kemi kapacitete të mjaftueshme” – mbas pak kohe vini dhe kërkonit rritje të stafit. Mendoj se kjo është e paarsyeshme dhe e panevojshme.

Së pari, në raportin që keni sjellë thoni se brenda një viti nga 28% e kërkesave kanë shkuar në 45%, që janë trajtuar, pra performanca është përmirësuar rreth 50%. Apo jo? Pse nuk vazhdoni kështu por kërkonit staf tjetër?

Së dyti, në qoftë se është një situatë, siç e ngriti edhe kolegja, që numri i ankesave vjen në rritje, përgjigja nuk është që t’u përgjigjesh atyre, por të bësh rekomandime për ndërhyrje ligjore, që këto ankesa të trajtohen në mënyrë ligjore, në mënyrë të përgjithshme dhe si kazuse reference. Pra, zgjidhet një kazus, i cili do të shërbejë edhe për të tjerat më pas, siç bëjnë edhe gjykatat në përgjithësi. Edhe për këtë arsye ju nuk duhet të vinit që të kërkonit rritje stafi.

Së treti, ju jepni argumentin, përsëri e them, se është rritur volumi i punës suaj. Nga 6 persona, vetëm 30% e tyre merren me çështjet konkrete. Të tjerët që nuk kanë të bëjnë fare me rritjen e numrit të ankesave, pse i shtoni?

Meqë mora fjalën, dua të ngre edhe dy çështje të tjera: mendoj se edhe ju, kryetar, duhet të mirëkuptoni problematikën që ngrihet për sa i takon eficiencës së prokurimit publik. Nuk mendoj se ka vend për acarim dhe injorim të këtij fakti, sepse besoj se të gjithë ne, rreth kësaj tryeze, e kemi merakun për shfrytëzimin e parave publike, jo vetëm të atyre që prokurohen nga institucionet tona publike, por edhe të parave të të gjithë shqiptarëve që prokurohen nga institucione të tjera, siç mund të jenë donatorët, ata të cilët shpeshherë i prokurojnë vetë paratë publike shqiptare. Mendoj se edhe ky do të jetë një objekt i vlerësimit nga ana juaj.

Ajo që doja të thosha është se çështja e eficiencës së prokurimit publik, ndonëse është politizuar shpeshherë, ka një thelb që është shumë problematik. Ajo që po ndodh është se paratë publike nëpërmjet ligjeve të posaçme i anashkalojnë rregullat themelore që ka prokurimi publik, që është konkurrimi i hapur dhe transparent. Është e vërtetë që ka ndodhur para pak vjetësh përgatitja e një ligji të veçantë për Rugën e Arbrit, por arsyeja për të ishte shumë e thjeshtë, ishin para të qeverisë kineze që do të investoheshin në infrastrukturën e Republikës së Shqipërisë, por nuk mund të vinin drejtpërdrejt nga qeveria kineze, por duhet të vijnë nëpërmjet një kompanie private. Prandaj u bë një ligj i posaçëm që të negociohej kontrata me këtë kompani private, gjë që nuk rezultoi e suksesshme, sepse oferta që morëm ishte shumë e shtrenjtë. Pra,

përqendruam tek integriteti dhe aftësia e shumë nëpunësve civilë shqiptarë të gjithë peshën, përgjegjësinë e asaj që ndryshe duhet ta kishte një proces konkurrimi normal ligjor. U refuzua kjo ofertë, sepse ishte shumë e shtrenjtë dhe nuk ishte në interesin publik. Ajo që po ndodh me rastet e tjera më pas, me koncesionet me PPP-të e tjera, qoftë me aeroportin e Vlorës, qoftë me Teatrin Kombëtar nuk më rezulton se është rast i ngjashëm. Në këto raste eliminohet krejtësisht mundësia e një oferte tjetër, eliminohet krejtësisht mundësia e konkurrimit dhe e ofertave alternative. Mendoj se kjo është një çështje shumë themelore, është shumë më themelore sesa fakti nëse ju shtoni me 6 vetë stafin tuaj apo jo.

Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithë kolegëve, edhe të kryetarit të Komisionit se kur ngrihen këto çështje kaq të rëndësishme, po flasim për miliarda para publike, të ketë durim gjithsecili dhe ta trajtojë çështjen në thelbin e saj.

Në fakt, nuk pres përgjigje nga ju, zonja kryetare, unë jam shumë i qartë, por e mbajta këtë fjalë për të thënë se jam kundër rritjes së numrit të stafit tuaj. U bie edhe unë kabanave për një vëmendje shumë më të lartë nga ana juaj dhe e të gjithë kolegëve deputetë për procesin e prokurimeve që ndodh në vend dhe për mënyrën sesi shpenzohen paratë publike.

Erion Braçe - Para se sa të përgjigjet zonja, zoti Haxhinasto dua të them se unë kam të gjithë durimin e mundshëm për të dëgjuar edhe për çështje të tilla si puna e Teatrit, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk folët për teatrin? Dakord.

Evis Shurdha- Atëherë, shkurtimisht, në lidhje me çështjen e stafit prezent, shtesat prej 6 punonjësish në Komisionin e Prokurimit Publik janë: një sekretar i Përgjithshëm që është detyrim ligjor për t'u shtuar për sa kohë që institucioni është i pavarur, i krijuar me ligj, një këshilltar për të qenë sinjalizues i këtyre problematikave dhe për të propozuar nesër ndryshimet ligjore qoftë edhe shqetësime për t'ia përcjellë Kuvendit për sa kohë që të gjithë ne jemi në përditshmërinë tonë të angazhuar me atë çfarë është objekti kryesor i veprimtarisë së Komisionit për Prokurimin Publik, dy inspektorë, për hir të së vërtetës pozicioni i inspektorit në KPP-së kërkon një trajnim të veçantë, duke pasur parasysh se i përket shërbimit civil ku edhe mobiliteti, por nga ana tjetër edhe zëvendësimi është shumë i vështirë, pasi kërkon afat të gjatë. Aktualisht kemi dikë me leje lindjeje, që do të thotë se sjellë vonesë në rishpërndarjen e dosjeve të inspektorit, për shkaqe të ndryshme personale ose profesionale, në lidhje me ndonjë trajnim që e parashikon ligji mund ta kryejë me iniciativën e tij, prandaj ne

duhet t'u dalim përpara këtyre situatave. Kuvendi nuk është një zyrë ku ne bëjmë vetëm aplikim dhe kërkojmë ndryshimin e strukturës, por ne marrim parasysh edhe një situatë apo skenar pesimist nevojat e institucionit. Kërkojmë edhe një specialist të IT-së shtesë në lidhje me sistemin *open data*, të cilin po e implementojmë aktualisht në KPP dhe funksionet e shtuara të raportuesve të KPP-së në lidhje me organizmat ndërkombëtare nuk mund t'i mbështesë apo nuk mund t'i kryejë më një inspektor i radhës, i cili nuk e ka në përshkrimin e punës dhe në formimin bazë këtë gjë.

Këto janë kërkesat tona.

Për kazuset, të cilat do të shërbejnë si referencë për vendimet e KPP-së, si edhe detyrimi ligjor për qëndrueshmërinë në vendimmarrje parashikojnë një standardizim dhe një orientim të autoriteteve kontraktore në zbatim të ligjit. Për sa kohë që KPP-ja është gati gjykatë dhe forca e vendimit të KPP-së nuk është ajo e vendimit të gjykatës, mbetet thjesht orientuese për autoritetet kontraktore.

Erion Braçe - Ka pyetje të tjera?

Përparim Spahiu - Faleminderit!

Nuk është pyetje, por më tepër një koment, fakti i kërkesës së institucionit tuaj për shtimin e numrit më ngacmoi të dhënat e INSTAT-it me të dhënat e para dy javëve se numri në administratën shtetërore në dy vjetët e fundit është rritur me 14 mijë njerëz. Qartazi duket se kjo ekonomi po zhvillohet në këtë mënyrë: të punësojmë në shtet. Ata që punojnë në shtet të jenë konsumatorë të këtij vendi, sepse pjesa tjetër është drejt emigracionit. Nuk shtohen investime të tjera. Ju bëni mirë të shfrytëzoni parlamentin për shtimin e numrit të punonjëseve.

Ndaj të njëjtin mendim me zotin Haxhinasto që më duket e panevojshme me argumentet që dhatë të shtohet ky numër, megjithatë të shikojmë se ndoshta edhe te KLSH-ja mund të ketë ndonjë kërkesë dhe ta shtojmë në raportin e KLSH-së që të bëjmë edhe disa punësime te kjo e fundit, nuk e di në institucionet e tjera, të mbarojnë edhe vetingun. Pra, duket e vetmja rrugë, i vetmi model ekonomik punësimi në shtet. Të shtohet administrata shtetërore me 14 mijë njerëz që me një llogari të përafërt shkon në 60 milionë euro në vit kosto nga buxheti i shtetit, them se nuk po bëjmë gjënë e duhur. Megjithatë është parlamenti dhe qeveria e zgjedhur nga vitit 2017 dhe shpresojmë që shqiptarët të jenë më koshientë kur të votojnë dhe të bëjnë gjëra më të mira.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Keni koment?

Evis Shurdha- Nuk priti përgjigje nga ana ime.

Erion Braçe - Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime rreth propozimit për strukturën e re të KPP-së? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e strukturës së re. Ka vetëm një votim. Do të bëhet vendimi respektiv i komisionit, i cili do t'i përcillet seancës plenare.

E nderuar zonjë, ka vetëm një shqetësim që ju nuk keni fonde për këtë shtesë deri në janar të vitit 2019. Pra, struktura do të bëhet efektive nga 1 janari i vitit 2019 kur të çelet buxheti i ri. Për këtë buxhet nuk ka absolutisht mundësi për të shtuar fonde për këtë gjë.

Evis Shurdha- Struktura dhe pozicionet shtesë jemi dakord që të bëhen pas 1 janarit, por nga ana tjetër mosmiratimi i strukturës na pengon në rekrutimin e pozicioneve aktuale...

Erion Braçe – Fola vetëm për pjesën buxhetore nga 1 janari i vitit 2019.

E hedhim në votim strukturën? Kush është pro? Kundër? Dy kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 16.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës për raportin vjetor të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ismet Beqiraj, Përparim Spahiu, Reme Lala dhe Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Agron Shehaj dhe Nadire Meçorapaj.

Erion Braçe - Kalojmë te çështja tjetër e rendit të ditën që është rezoluta e komisionit për raportimin vjetor të KLSH-së.

Zonja Gjylameti keni fjalën.

Blerina Gjylameti – Projektrezolutë për vlerësimin e veprimtarisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së pari po filloj me vlerësimin paraprak dhe më pas me rekomandimet. Pas analizës së shqyrtimit dhe diskutimit të raportit të KLSH-së për vitin 2017 Kuvendi i Shqipërisë konstaton se KLSH-ja gjatë vitit 2017 vijoi me përmbushjen e objektivave të Strategjisë së Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si një prej sfidave më dinamike me të cilat përballen të gjitha institucionet e auditimit të jashtëm në nivel global. KLSH-ja ka përmbushur misionin e saj kushtetues dhe ligjor, duke informuar në mënyrë periodike, të paanshme dhe të plotë Kuvendin, palët e interesit dhe qytetarët për përgjegjshmërinë që pushteti ekzekutiv dhe entet publike tregojnë në përdorimin e fondeve publike. Ky informim ka kontribuar në thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e qeverisjes. Veprimtaria e KLSH-së ka rezultuar në përmbushje të kërkesave të rezolutës së Kuvendit në disa aspekte: në zbatimin e strategjisë institucionale dhe regjistrin e riskut, metodologjinë e planifikimit të auditimeve mbi bazë të rëndësisë së lartë ekonomike dhe indicieve, në vijimësi, kontrollin e cilësisë së auditimeve, paraqitjen e raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve, dëmin e konstatuar ekonomik sipas subjekteve, evidencën e kallëzimeve penale dhe statusin e tyre, si edhe ankimimet e KLSH-së në rastet e pushimit të çështjeve nga organi i akuzës.

Veprimtaria e KLSH-së është vlerësuar nga institucionet mbikëqyrëse ndërkombëtare, nga programi SIGMA-OECD i Bashkimit European dhe nga Banka Botërore, Komisioni European si një faktor përcaktues për rritjen e përgjegjshmërisë në përdorimin e parasë publike, rolit të tij në luftën kundër korrupsionit, si dhe pozicionit të KLSH-së në implementimin e objektivave të axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm 2030.

Viti 2017 ishte viti i fundit i zbatimit të strategjisë së zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2017, njëherazi edhe një vit në të cilin KLSH-ja lançoi strategjinë e re për vitet 2018-2022, hartuar në bazë të arritjeve të planit të mëparshëm me një sërë objektivash të qarta dhe plane pune në varësi të ndryshimeve të mjedisit dinamik në të cilin vepron institucioni.

Performanca vjetore institucionale e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2017 është fokusuar në tri shtylla kryesore:

Së pari, në punën audituese.

Së dyti, në menaxhimi institucional, strategjitë dhe asistencën ndërkombëtare.

Së treti, në komunikim dhe në transparencë.

Drejtimet e auditimit kanë synuar të realizojnë një mbulim sa më të plotë të zbatimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet rritjes së numrit të subjekteve të audituara, duke rritur produktivitetin dhe eficiencën e punës audituese, duke përdorur gjithnjë dhe më shumë qasjen e bazuar në risk dhe mbështetjen e punës së saj në proceset dhe teknologjitë e reja.

KLSH-ja ka ndjekur një politikë të zhvillimit dhe modernizimit institucional të lidhur ngushtë me krijimin dhe përsosjen e kapaciteteve audituese. Si pasojë është rritur numri i auditimeve në tërësi si dhe përparësia në qasjet e reja audituese si: auditimi i performancës, i teknologjisë së informacionit dhe atij financiar, duke përmbushur kërkesat e rezolutës së Kuvendit, rekomandimet e SIGMA-s dhe standardet e INTOSAI-t.

Nga auditimet e ushtruara gjatë vitit 2017 Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në kundërshtim me kërkesat ligjore, mbeten në fushën e keqmenaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të fondeve buxhetore, keqadministrimit të pronës shtetërore e pasuar nga parregullsitë si dhe inefficiencat në fushën e prokurimit publik.

KLSH-ja ka evaduar 156 auditime nga 154 të planifikuara nga të cilat 92 auditime rregullshmërie, 25 auditime përputhshmërie, 14 auditime financiare, 15 auditime performance, 5 auditime tematike dhe 5 auditime IT-je.

Për sa u përket institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, KLSH-ja ka audituar 69 institucione qendrore, projekte me financim të huaj 11, në qeverisjen vendore 59, 16 shoqëri aksionere në korporatat publike, institucione të nivelit qendror e vendor, 15 auditime të performancës, të cilat janë zhvilluar në 110 institucione qendrore dhe vendore.

Gjatë vitit 2017 KLSH-ja ka adresuar 91 propozime për ndryshime në legjislacion me spektër të gjerë që përfshijnë amendime kushtetuese, ndryshime të ligjeve bazë, si dhe ndryshime të vendimeve të Këshillit të Ministrave apo dhe akte të tjera rregullative, si dhe 3521 masa të natyrës organizative, disiplinore dhe administrative nga të cilat janë pranuar 1937 ose 55% e masave të rekomanduara, ndërsa 1584 masa janë duke u shqyrtuar nga subjektet.

Vijon edhe këtë vit të mbetet shqetësues niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga organet e administratës publike

KLSH-ja ka kryer kallëzimet penale, në kuadër të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes. Për vitin 2017 KLSH-ja i ka adresuar organit të prokurorisë 47 kallëzime penale për 129 zyrtarë të nivelit të lartë dhe të mesëm.

Instrumentet e transparencës janë diversifikuar duke përfshirë jo vetëm publikimet dhe pjesëmarrjen në medie, por edhe duke rritur profilin shkencor të debatit nëpërmjet konferencave shkencore në partneritet me akademikët, universitetet, shoqërinë civile si në nivelin kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me Kuvendin e Shqipërisë, marrëdhëniet dhe komunikimin midis dy organeve gjatë vitit 2017 dhe në vijim janë forcuar me një fluks të shtuar të informacioneve, buletineve periodike, rezultateve dhe raporteve të auditimit që përcjell KLSH-ja në Kuvend si gjatë vitit 2017 ashtu edhe në vitin 2018, të cilat kanë ndikuar në rritjen e vëmendjes së deputetëve për punën dhe angazhimin e KLSH-së.

Për vitin 2018, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Kontrolli i Lartë i Shtetit fokusimin, në mënyrë të veçantë në këto drejtime:

Fillimin e zbatimit të strategjisë së zhvillimit institucional sipas planit strategjik të veprimit, me qëllim përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të institucionit në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe paraqitjen e raportit të monitorimit të saj pranë organeve të Kuvendit.

Vijimin e zbatimit të strategjisë së komunikimit për vitet 2017-2019 dhe raportimin periodik lidhur me organet e Kuvendit.

Forcimin e mëtejshëm i pavarësisë së institucionit, për të siguruar auditime të paanshme dhe objektive.

Monitorimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve që u adreson organeve të administratës publike, në mënyrë të veçantë rekomandimet e pranuar formalisht prej tyre. Informacioni në raportin vjetor të KLSH-së për nivelin e zbatimit të rekomandimeve duhet të jetë i përditësuar çdo 3 muaj në Kuvend.

Auditimet dhe puna e KLSH-së duhet t'i paraprijnë ngritjes së vëmendjes së organeve përgjegjëse, duke synuar kapjen në kohë të gjetjeve dhe të rekomandimeve, të cilat duhet të zbatohen si masa që u paraprijnë shmangies dhe parandalimit të praktikave korruptive dhe abuzive në funksion të forcimit të kulturës së ndëshkueshmërisë dhe të mirëqeverisjes. Rritja e numrit të auditimeve financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, të

qeverisjes së përgjithshme deri në arritjen e objektivit final të dhënies së opinionit për pasqyrat financiare të gjithë qeverisë.

Konsolidimi i auditimit me bazë risku, për të siguruar rritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve publike, si dhe forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës, i cili ka një rol të rëndësishëm në përdorimin me ekonomi, si dhe në rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike.

Thellimi i auditimit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet konsolidimit dhe përdorimit të elementeve të tij në auditimet e përputhshmërisë financiare dhe të performancës. Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Përmirësimi i cilësisë së auditimit për të rritur dobinë e tij. KLSH-ja duhet të konsolidojë sistemin e cilësisë dhe kontrollit, si dhe përmirësimin e metodologjisë së zbatimit të kuadrit ligjor e rregullator. Kontrolli i cilësisë duhet të mbështetet nga sigurimi i cilësisë, i cili kryhet nga persona që nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit.

Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nëpërmjet përmirësimit të procedurave brenda institucionit dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional me angazhim kryesor jo vetëm bashkëpunimin me Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, por edhe komisionet e tjera parlamentare

Rritja e impaktit të raportimeve të KLSH-së, duke zgjeruar përcjelljen profesionale dhe të kuptueshme të mesazhit të auditimit te palët e interesuara dhe të qytetarëve, bazën e përdoruesve të tyre, duke përmirësuar formatin e tij dhe gjuhën e kuptueshme të tij.

Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe aftësive audituese, si dhe vendosjen e sistemit të certifikuesve të auditimit të jashtëm publik.

Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe forcimi i komunikimit dhe bashkëveprimit me Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha nivelet e tij të përfaqësimit parlamentar, si dhe atij administrativ.

Rritjes së rolit më aktiv dhe cilësor të KLSH-së në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit në përgjithësi dhe për atë të investimeve dhe prokurimeve publike në veçanti si: të rrisë angazhimin në ndjekjen e përmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, axhenda 2030, me fokus të veçantë objektivin 16 për transparencë, eficiencë dhe llogaridhënie.

Kuvendi i Shqipërisë,

Në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese, por dhe në zbatim të rekomandimeve të raportit të Komisionit European 2018 dhe zbatimit të mekanizmit ndërinstitucional të ngritur me vendim të Kuvendit nr.49/2017, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së sa më poshtë:

Të forcojë bashkëpunimin me KLSH-në dhe pushtetin ekzekutiv, që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Për rekomandimet në aspektin e përmirësimit të legjislacionit, sugjerohet që Kuvendi dhe KLSH-ja të organizojnë, të paktën 2 herë në vit seanca dëgjimore me institucionet përkatëse dhe grupet e interesit, me qëllim vlerësimin e situatës ligjore dhe finalizimin e nismave ligjvënëse.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar, duhet të angazhohet të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike. Të miratojë pa vonesa krijimin e nënkomisionit parlamentar brenda Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve.

Të monitorojë çdo 6 muaj statusin e pranimi dhe të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Nga ana tjetër të rritet vëmendja e deputetëve dhe e komisioneve parlamentare përtej atij përgjegjës për Ekonomisë dhe Financat për shtimin e instrumenteve të tjera parlamentare të kontrollit bazuar edhe në masat që përcakton mekanizmi ndërinstitucional.

Komisioni për Ekonomisë dhe Financat nxit KLSH-në që të thellojë më tej hetimin e blerjes së hotel Dajtit në kushtet e financimit me emetim të monedhës, pavarësisht faktit se të ardhurat mund të ishin të mjaftueshme për të bërë një blerje të tillë; të auditojë fenomenin e shfrytëzimit të burimeve natyrore në raport edhe me ndikimin në mjedis, auditimin e lejeve minerare dhe ndikimin e tyre në mjedis, si dhe auditim të plotë të ndërtimit të rrugës Rrëshen-Kalimash- Kukës-Morinë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kush e do fjalën?

Po, urdhëroni!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Unë dua të shpreh vlerësimin për raportin që është paraqitur para këtij komisioni për elementet e reja inovative që ka dhe për përpjekjet serioze për përmirësimin e performancës në përgjithësi të sektorit publik.

Do të doja që këtë projektrezolutë ta kishim marrë më përpara dhe ta kishim studiuar më me kujdes, megjithatë po jap disa rekomandime për sa u takon elementeve që mund të jenë në këtë projektrezolutë.

Duke pasur parasysh që raporti i sjellë këtu nga KLSH-ja paraqet vlera të konsiderueshme të dëmit të shkaktuar nga institucione të ndryshme, sigurisht kjo e përkthyer në individë, vlerësoj se vendoja e një indikatori mund të ishte më orientuese për të kuptuar se çfarë efekti ka pasur gjetja e këtyre dëmeve dhe masat që janë marrë më tej. Për të qenë më konkret mund të vendoset indikatori se sa është vlera e rikuperuar nga dëmet që janë paraqitur. Pra, nëse thuhet se janë rreth 800 miliardë, ku e di unë se sa është vendosur ekzaktësisht, sa është rikuperuar nga kjo vlerë?

Rekomandimi i dytë është që indikator të jetë edhe numri i çështjeve të fituara, si përqindje e çështjeve të përgjithshme të paraqitura pranë gjykatave shqiptare.

Së treti, mendoj se një element tjetër, që duhet parë me kujdes, duke qenë se i shërben sektorit publik dhe privat, se sektori privat është partner me atë publik, është edhe detyrimi i sektorit publik ndaj atij privat. Ky është një nga indikatorët më të rëndësishëm të performancës së institucioneve publike, mënyra se si ato e ndihmojnë ekonominë dhe si e mbështesin sektorin privat. Pra, do të ishte një element i rëndësishëm për të na treguar se si institucionet publike performojnë për t'i shërbyer ekonomisë dhe sektorit privat.

Së katërti, dua të vlerësoj edhe një herë dimensionin e vlerësimit të performancës që është trajtuar në raport, që ju e keni vendosur edhe në projektrezolutë, por dua të theksoj, gjithashtu, se është e nevojshme që edhe qeveria të jetë subjekt i vlerësimit të performancës së saj. Sigurisht që qeveria vlerësohet politikisht edhe nga elektorati, por edhe një institucion i specializuar për realizimin dhe për performancën e detyrimeve të saj do të ishte i nevojshëm nga ana e KLSH-së, duke qenë se këtë dimension, pra vlerësimin e performancës, e ka si një nga drejtimet kryesore të punës që realizon.

Rekomandim tjetër është që në radarin e këtij komisioni të jetë performanca e projekteve të huaja, sepse shoh që shpeshherë dalin nga radari i vlerësimit të institucioneve publike shqiptare dhe shohin probleme shumë të mëdha në performancën e projekteve të huaja, edhe nga ato që prokurohen nga vetë institucionet e huaja. Do të rekomandoja, gjithashtu, që një vëmendje e posaçme të tregohet për të gjitha PPP-të, të cilat kanë qenë temë e diskutimit publik, për të cilat janë mbajtur qëndrime kundërshtuese, por që kanë interes të madh publik për të gjitha koncesionet e kontratat e rëndësishme jo vetëm për rrugën Milot-Morinë, por edhe për të tjerat. Për këto duhet të ketë një vëmendje të veçantë dhe ta vendosim në rezolutë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është që të bëhet një rivlerësim i njësive të auditimit që ka në institucionet publike. Të mos ketë dublime, të ketë seriozitet dhe të mos ketë fiktivitet të kjo armatë e madhe njerëzish që punojnë në njësitë e auditimit të institucioneve publike. Mund të ishte më efikase, mund të punohej me rritëm më të mirë bashkë me ritmin që imponon KLSH-ja.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Haxhinato!

Pa asnjë lloj diskutimi që në rezolutë mund të shtohet cilado nga çështjet që ngritët, por duke u nisur nga dy të fundit, do të doja të thosha që KLSH-ja e ka detyrim ligjor të kontrollojë edhe performancën e auditeve të brendshme të secilës prej ministrive, apo agjencive të tjera. Kur KLSH-ja shkon të kontrollojë një institucion të caktuar, ka pjesë në raportin të tij edhe për auditin e brendshëm të tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

KLSH-ja bën vlerësim për punën e tyre, pastaj u takon autoriteteve përkatëse që në raport me rekomandimet që bën KLSH-ja, apo gjetjet e saj në raport me auditin e brendshëm, të marrin vendimet e tyre, por mund të jetë pjesë e rezolutës pa asnjë lloj problemi.

Në dijeninë tim, KLSH-ja ka një marrëveshje me Komisionin European për projektet e huaja, në degën e tij në Tiranë, për të kontrolluar të gjitha projektet që financohen nga Komisioni European. Nuk e di nëse është e mundur që kjo gjë të bëhet edhe me Bankën Botërore apo edhe me agjenci të tjera financuese, siç është BERZH-i. Do të duhet që ta flasim me kryetarin e KLSH-së se deri ku shkon caku i tij ligjor në marrëdhënie me BB-në, i cili është donatori kryesor, pastaj me BERZH-in.

Edmond Haxhinasto – Dua të sqaroj diçka këtu.

Po flas për para që janë kredi, pra, para publike shqiptare.

Erion Braçe – Për ato po flas edhe unë. Ato janë të kontrollueshme.

Edmond Haxhinasto – Nuk duhet të ketë asnjë kriter që të na pengojë të shohim se mënyrën se si...

Erion Braçe – Jo, ato janë të gjitha të kontrollueshme.

Edmond Haxhinasto – Ato janë paratë e popullit shqiptar, janë para publike.

Erion Braçe – KLSH-ja ka bërë dy raporte shumë të mira, qoftë për bajpasin e Fierit qoftë për bajpasin e Vlorës, ashtu siç ka bërë edhe për rrugën Levan-Tepelenë, Levan-Vlorë. Pra e ka pjesë të punës dhe të kontrollit të tij të përditshëm. Nëse nuk janë marrë parasysh ato kjo është çështje tjetër, por për pjesën e fondeve që merren kredi nga shteti shqiptar, ka të gjithë autoritetin për t'i kontrolluar. Kontrolli është shtrirë edhe te fondet që prokurohen vetë nga organet e Komisionit European dhe ka një marrëdhënie të caktuar mes KLSH-së dhe Komisionit European në Tiranë pikërisht për këtë gjë dhe kanë ushtruar kontrolle edhe për to. Në raportet e tyre kanë një pjesë të posaçme pikërisht për këtë gjë.

Ndërkohë, për sa i përket qeverisë, unë mendoj se ajo është një trupë politike, kështu që nuk e di se cili do të jetë institucioni i caktuar, përtej KLSH-së, për të dhënë vlerësime për performancën e qeverisë, por do të doja që KLSH-ja të mos përfshihej në politikë në këtë rast. Pa asnjë lloj diskutimi që KLSH-së duhet t'i rekomandohet se vlera e rikuperuar nga dëmet e zbuluara nga KLSH-ja, duhet të jetë një çështje e raportueshme vit pas viti në raportin e KLSH-së. Kjo për mua është serioze dhe KLSH-ja duhet të raportojë edhe për këtë gjë, siç raporton për marrjen parasysh të rekomandimeve të tij, ashtu të raportojë edhe për këtë pikë. Kështu duhet përfshirë e gjitha në rezoluta.

Për çështjet e hetuara nuk e di se sa mundësi do të ketë KLSH-ja ta bëjë këtë gjë, sepse kam përshtypjen se KLSH-së i shkon detyrimi nga kallëzimi e deri te ndjekja e vendimmarrjes që bën prokuroria. Në dijeninë time kryetari i KLSH-së i është drejtuar gjykatës për të gjitha çështjet që ka kallëzuar gjatë vitit 2017 dhe janë pushuar, apo nuk janë hetuar me vendim të prokurorisë. Për këtë gjë ka një raportim të qartë në raport dhe një departament i caktuar i KLSH-së po e ndjek këtë çështje në gjykata.

Për çështjen e detyrimeve, e kishit fjalën për detyrimet financiare që krijon qeveria përkundrejt privatit? Bëhet fjalë për detyrimet e prapambetura? Edhe unë jam dakord me ju që të vendoset në rezolutë dhe KLSH-ja ta ndjekë këtë çështje me precedencë për secilën prej tyre,

bile ta ndjekë dy herë në vit, si në momentin kur raporton për veprimtarinë e tij gjatë një viti, ashtu dhe në momentin kur ka raport të posaçëm për buxhetin faktik të vitit pararendës. KLSH-ja të raportojë në mënyrë të posaçme për këtë gjë, me qëllim që të rakordojë numrat edhe për këto detyrime përmes qeverisë dhe KLSH-së.

Zonja Gjylameti, të përfshihen çështjet.

Fjala për ju.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Jam më se dakord edhe unë me shqetësimet apo propozimet e zotit Haxhinasto, por mendoj se në raportin e KLSH-së janë të shtjelluara çështjet e parave të rikuperuara nga dëmi i shkaktuar, po ashtu edhe çështjet e mbyllura, thjesht do të duhet të kemi një fokus të posaçëm, që të kemi të dhëna krahasuese vit pas viti për të parë se si ndryshon. Pra, në rezolutë do të duhet të shtohet fokusi i posaçëm në mënyrën e raportimit, por ne i kemi si të dhëna.

Së dyti, për sa i përket pjesës së projektrezolutës së vitit 2016, apo auditimit i të gjitha projekteve të financuara me paratë e huaja, ne kemi pasur pjesën tonë në atë rezolutë ku i kërkonim KLSH-së që të përfshijë në auditim edhe ato projekte, të cilat janë të financuara me para joshqiptare, pra, kryesisht nga Komisioni European, apo BE-ja, dhe nga BB-ja e BERZH-i.

Ndërkohë, zoti kryetar, për sa i përket pikës së fundit, që unë përmenda, mendoj se disa nga pikat që ngritëm dhe janë reflektim i shqetësimeve që patëm bashkë gjatë raportimit të kryetarit të KLSH-së jo vetëm për raportin e vitit 2017 duhet të kenë fokus të posaçëm. Po qe se do t'i kushtonim pak më shumë vëmendje do të kuptonim se është një përmbledhje e punës së tij ndër vite që nga momenti që ka marrë detyrën e deri sot.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

A ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Kalojmë për votim projektrezolutën bashkë me dy shtesat respektive.

Po, urdhëroni!

Përparim Spahiu – Normalisht, zoti Haxhinasto ngriti shqetësimin që në rezolutë të mos përmendet vetëm Rruga e Kombit, por KLSH-ja të përfshihet në auditimin e të gjitha PPP-ve të dhëna, pra të japë mendim. Ka qenë edhe shqetësim i FMN-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo rrugës, se aty bëhet fjalë vetëm për një rrugë. Ka një kërkesë të një deputeti që specifikon rrugën Rrëshen-Kalimash, pra pse të mos përfshijmë një projektrezolutë auditimin specifik, sidomos të PPP-ve, pasi janë kthyer vërtet në shqetësim për FMN-në dhe për ne, si opozitë, me qëllim që të përfshihen të gjitha kontratat me PPP.

Blerina Gjylameti – KLSH-ja është e përfshirë në të gjitha kontratat PPP dhe i auditon ato. Vendosija në fokus të disa prej zërave ishte në vazhdimësi për të nxitur. Aty thuhet: “Nxsisim punën në drejtim të...”, edhe PPP-të i kanë në të gjitha planet e tyre audituese.

Erion Braçe – Ndërkohë më lejoni t’ju them së KLSH-ja i ka audituar të gjitha kontratat e PPP-ve në shëndetësi dhe ka edhe rekomandimet respektive, por është e pamundur të flitet këtu në prezencë të disa kolegëve. Kështu që KLSH-ja i ka pjesë të raportit të vet dhe i ka audituar në kushte profesionale dhe gjetjet e tij janë profesionale në këtë aspekt, prandaj PPP-të nuk janë të pakontrollueshme, kanë qenë të kontrollueshme, ndërkohë që të rehat t’i kontrollojë nga fillimi deri në fund.

A ka ndonjë gjë tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të them të drejtën, Rruga e Kombit nuk është shqetësimi im, por shqetësim kombëtar, se paguajnë të gjithë për të.

Përparim Spahiu – Dakord, por mbrëmë po kthehesha nga Dibra dhe pashë që kishte goxha lëvizje. Pashë kosovarë që ktheheshin në Prishtinë, prandaj të mos i hyjmë thelbit. Është shumë mirë që u bë ajo rrugë, do të ishte mirë të bëhej edhe ndonjë tjetër dhe të kontrollohet.

Erion Braçe – Që rruga është bërë, kjo pa diskutim është një gjë e mirë dhe këtë nuk e ka mohuar njeri. Më vjen keq se ju nuk keni qenë fare prezent, nuk keni dëgjuar asgjë dhe nuk keni pse të gjykoni, por natyrisht mund të bëni vlerësimet tuaja.

Përparim Spahiu – Po pse e keni këtë shqetësim? Unë nuk kërkoja të bëhet një kontroll specifik për recetën elektronike që nuk funksionon, thjesht thashë që të jetë një kërkesë e përgjithshme për dhënien e PPP-ve. Gjithashtu, shpreha edhe shqetësimin e FMN-së. Rruga e Kombit u bë dhe shumë mirë që është bërë, jam shumë i kënaqur që mbrëmë në darkë shihja me mijëra makina që ktheheshin për në Prishtinë. Është kosto oportune. Me mirë të ishte, apo jo? Për mua mirë që është, madje duhej të kishim bërë edhe një rrugë tjetër.

Erion Braçe – Ajo që kam kërkuar unë, për fat të keq në mungesën tuaj, nuk ka lidhje fare me këto që ju po thoni.

Përparim Spahiu – E drejtoni komisionin sikur ne jemi studentë dhe vijmë të na mësosh ti, se nuk kemi mendimin tonë.

Erion Braçe – Nuk mund të kesh mendimin tënd të gabuar për mua.

Përparim Spahiu – Përse e zgjat? Fillove prapë?

Erion Braçe – Po e sqaroj edhe një herë tjetër.

Përparim Spahiu – Çfarë ke? Qetësohu!

Erion Braçe - Nuk të ndërpreva, prandaj mos më ndërpre!

Përparim Spahiu – Nuk jemi studentë ne këtu, një herë na thua “a merr vesh” e një here “nuk merr vesh”.

Erion Braçe – Mos më ndërprit! Më lër të flas!

Po të them se po jep një gjykim për një çështje që e kam ngritur vetë dhe ti nuk ke qenë prezent. Tani, me lejo mua të sqarohem!

Përparim Spahiu – Nuk kam qenë prezent, se nuk jam paguar nga Kuvendi.

Erion Braçe – Punë e madhe se nuk ke qenë prezent, nuk të gjykoj, është dëshira jote të mos jesh.

Përparim Spahiu – Nuk do të na mësosh ti çfarë të flasim? Çfarë e ke këtë ves?

Erion Braçe – Nuk mund të flasësh për mua. Kaq po të them.

Kërkesa që kam paraqitur unë para kryetarit të KLSH-së ka të bëjë me një shqetësim kombëtar.

Përparim Spahiu – Për mua nuk është shqetësim kombëtar. Punë e madhe se është shqetësim për ty.

Erion Braçe – Puna jote nëse nuk është shqetësim, për mua është shqetësim kombëtar. Nuk ka ngritur njeri shqetësimin pse u bë rruga, përkundrazi, shqetësimi është pse nuk është bërë dhe sa ka kushtuar

Përparim Spahiu – Pse nuk e ke bërë Rugën e Arbrit?

Erion Braçe - Pra shqetësimi është pse nuk janë bërë këto të dyja dhe sa do të jetë vlera e koncesionit që do të paguajmë. Ky është shqetësimi që kam ngritur, sepse unë e kam problem të paguaj nga xhepi im për gjëra që i ka vjedhur dikush tjetër. Ty të pëlqen të paguash? Vazhdo paguaj, por nuk ma detyron dot edhe mua këtë gjë. Po e përsëris, ajo që kam kërkuar është të auditohet nga fillimi deri në fund rruga Rrëshen-Kalimash-Morinë.

Përparim Spahiu – Thuaj që të auditohet PPP-ja e shëndetësisë!

Erion Braçe – Është audituar, por që ta dish këtë gjë duhet të lexosh raportet e KLSH-së për koncesionet e shëndetësisë. Janë kontrolluar dhe i ke të publikuara. Nuk do të lexosh është çështja jote.

Kalojmë në votim.

Përparim Spahiu – Po të them edhe një herë mundohu të sillesh ndryshe në këtë komision.

Erion Braçe – kursehu kur jep vlerësime për të tjerët. Kur je prezent bëj ç'të duash, por kur nuk je prezent mos jep fare vlerësime. Zero. Për mua jo njëherë.

Përparim Spahiu – jam sot prezent.

Erion Braçe – po ta lejoj ndonjë tjetër bëje, me mua jo, ashtu sikurse nuk jap vlerësim për ty nuk ta lejoj të japësh vlerësim për mua, zero.

Ka ndonjë shqetësim tjetër lidhur me rezolutën?

Kalojmë në votim. Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka faleminderit! Zonja Gjylameti të reflektohen ato dy gjerat dhe t'i kalohet seancës për ditën e enjte. Të njoftohet dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

MBYLLET MBLEDHJA